

E DIEL
18 Qershor
2017



e-mail: milosao2005@yahoo.com



Historia e KOMNINO-s, shqiptarit që në 1464 ishte

ANËTAR I KËSHILLIT TË MADH TË VENEDIKUT

Performanca e Berlinit, 31 Dhjetor 1988, me pianistin Evgenij Kisin dhe dirigjentin e BPO Herbert von Karajan, mbetet ngjarja historike më e madhe të dy gjenive'. Koncerti u organizua me rastin e festës së Vitit të Ri. Në atë kohë pianisti Kisin ishte vetëm 17 vjeç por interpretimi i tij në piano ishte tepër elegant, tingulli i pianos doli i pastër si kristali, toni i pianissimo's ishte i këndshëm dhe tërheqës ndërsa virtuozi-teti i pianistit të ri shkëlqeu veçanërisht në finale. Në rubato ai u tregua, gjithashtu mjeshër i vërtetë. Të gjithë ata që patën fatin të ishin në sallë në atë fund viti, prej interpretimit të pianistit Kisin diriguar prej Karajanit të madh, u zhytën në një atmosferë vërtet misterioze, plot emocione melodish të bukura 'çajkovskiane'. Cadenza e pjesës së parë ishte gati e heshtur ashtu si dirigjenti dhe orkestra, që fillimisht qëndruan në heshtje, bashkë me audiencën berlineze në sallë. Pas kësaj, orkestra e theu heshtjen me duart e Karajanit ndërsa Kisin-i e mbajti audiencën të magjepsur me melodinë e pahar-

rueshme të koncertit. Ai luajti si gjithnjë, në mënyrë të moderuar veç duke krijuar efekt të madh. Harqet e Filarmonisë së Berlinit ishin në një nivel të lartë dhe shpesh ndikuan në rritjen e forcës

emocionale, plot bukuri dhe ekspresion. Virtuoziteti dhe muzikaliteti i pianistit 17 vjeçar shkëlqeu në të gjithë piano-koncertin, duke u daluar prej interpretuesve të tjerë të këtij piano-koncerti. Ai fitoi admir-

imin e të gjithëve, që prej masave të para të Allegro's. Evgenij Kisin luan në mënyrë brilante dhe orkestra performë në standardin e saj më të lartë duke sjellur kështu një performancë të eksituar

të një punimi të interpretuar shumë shpesh.

Vihet re te koha e parë se disa pasazhe që mendohet se janë në pianissimo, ata në fakt janë pianissimo (ppp) veçanërisht aty

Historia e performancës më të mirë historike në piano

(Në vazhdim të muajit të Çajkovskit)



Karajan dhe Kirin

ku tempo është e ngadaltë. Pianisti Kisin, edhe pse e luajti koncertin e pianos në Si b minor me 4 minuta më shumë, se sa Emil Gilels, efekti mbi audiencën ishte i madh sepse kjo i krijoi mundësi muzikës të shkëlqente më tepër, me një madhësi të paparë, duke sjellë një moment emocional, të cilin Çajkovski e kishte llogaritur saktësisht me orkestrimin. Gishtërinjtë fantastikë të pianistit Kisin duken qartë në dvd jo vetëm për shpejtësinë e goditjeve mbi tastet e pianos por edhe në akordet masivë. S'ka dyshim se balanca midis solistit Kisin, dirigjentit dhe orkestres ka qenë shumë e qëndrueshme.



Vijon në faqen 14

A

ARGUMENT

Performanca e Berlinit më 31 dhjetor 1988 me pianistin Evgenij Kisi dhe dirigjentin e BPO Herbert von Karajan, mbetet ngjarja historike më e madhe e të dy 'gjenive'. Koncerti u organizua me rastin e festës së Vitit të Ri. Në atë kohë pianisti Kisi ishte vetëm 17 vjeç por interpretimi i tij në piano ishte tepër elegant, tingulli i pianos doli i pastër si kristali, toni i pianissimo's ishte i këndshëm dhe tërheqës, ndërsa virtuoziçiteti i pianistit të ri shkëlqeu veçanërisht në finale...

Kisi, pianisti që u quajt "gjenial" me piano-koncertin No.1 të Çajkovskit

NGA SUL GRAGJEVI,
KRITIK I MUZIKËS
HARALLAMB FANDI,
KRITIK I ARTEVE

Vijon nga faqja 13

Një performancë e tillë, triumfuese, si kjo e vitit 1988, ende nuk është parë nga pianistë të tjerë dhe për këtë, është quajtur 'performanca botërore' e pianistit më të mirë dhe e dirigjentit më të mirë. Piano-koncerti i Çajkovskit No.1 në Si b minor, arriti rezultat monumental. Dirigjenti legjendar e mbështeti dhe inkurajoi pianistin e ri, adoleshent, Kisi. Pasioni i tij, forca e pabesueshme, aftësia, shkathtësia bashkë me muzikalitetin ishin në shkallën më të lartë dhe u regjistruan menjëherë në Dvd dhe Cd, për tu bërë frymëzim për të gjithë muzikantët e rinj, admirues të muzikës së Çajkovskit.

Mbrëmja e Berlinit, e 31 Dhjetorit 1988, do të ishte mbrëmja më e bukur e pianistit të ri deri atë kohë, kujtimi i së cilës do të mbetet për gjithë jetën.

Në fund të koncertit dirigjenti legjendar, i përloitur nga përshtypja e interpretimit brilant të pianistit të ri, u dëgjua të ketë thënë me zë të ulët "gjeni".

Por si u arrit kjo mrekulli?

Për ta kuptuar më mirë këtë duhet të njihemi më parë me veprën dhe përhapjen e saj që nga performanca e premierës së koncertit i cili u bë për Kisi-in-in shndritës i rrugëtimit të tij pianistik.

"Piano-concerto famous" e quajmë koncertin për piano dhe orkester në Si b minor të P.I. Çajkovskit si të shkruar më 1874-75. Premiera e koncertit u bë në Boston më 25 Tetor 1875 me Hans von Bülowë në piano. Në fakt, Çajkovski e kompozoi veprën për ta interpretuar Nikolaj Rubinshtein-i, pianist virtuoze dhe drejtor i Konservatorit të St. Petersburgut, gjithashtu dhe mik i kompozitorit. Mirëpo ai nuk pranoi ta luante koncertin në premierë duke e quajtur si të "painterpretueshëm" dhe partiturën, si të "pavlerë". Në të njëjtën kohë, pianisti i famshëm kërkoi nga kompozitori që ta rishkruante koncertin, por Çajkovski nuk pranoi t'i bënte asnjë ndryshim, madje tha: "Unë nuk do ta revizionoj koncertin e pianos, nuk do t'i lëviz veprën asnjë note dhe do ta publikoj saktësisht ashtu siç është". Përveç kësaj, Çajkovski menjëherë ia dëdhi koncertin e pianos pianistit



Karajan-Kisi

Hans von Bülowë.

Në Janar 1875, Çajkovski e përfundoi edhe orkestracionin e koncertit duke e plotësuar kështu të gjithë punën, pa e ndryshuar nga dorëshkrimi dhe kërkoi nga pianisti gjerman Hans von Bülowë ta ekzekutonte pasi i dërgoi të gjithë partiturën e re të shkruar. Premiera e Bostonit pati një sukses të madh, masiv.

"Koncerti juaj op.23 në Si b minor-i shkruante Bülowë Çajkovskit tregon me brilancë, një arritje të shënuar midis punimeve tuaja në muzikë, në saj të talentit tuaj të jashtëzakonshëm"... "Ju meritoni mirënjohjen e të gjithë pianistëve, sepse e pasuruat botën e muzikës si kurrë më parë. Aty gjen origjinalitet të pashoq, forcë, fisnikëri, krahas momenteve mahnitëse në të gjitha pjesët, një pjekuri të formës së koncertit, të stilit, me harmoni consonante...Me një fjalë, ky margaritar i Juaji i vërtetë, ka për të merituar mirënjohjen e të gjithë pianistëve". Ndërsa Çajkovski, në një letër që ia dërgonte Rim-ski-Korsakovit, i shkruante për suksesin e madh të performancës së Bostonit: "Me ç'dëshirë e dëgjoni amerikanët! Në çdo ekzekutim të koncertit tim, finalja e von Bülowë t ishte e destinuar të përsëritej".

Hans von Bülowë ishte figurë e rëndësishme e botës muzikore Gjermane, ai e krijoi dhe e ngriti figurën e vet si pianist dhe dirigjent qysh në fillimin e karrierës së tij. Pianisti gjerman nuk ishte nacionalist çjerrës dhe e mori piano-koncertin e Çajkovskit me shumë interes e dëshirë për ta interpretuar. Suksesin ndërkombëtar i koncertit No.1 op.23 e bindi edhe Nikolaj Rubinshtein për vlerat e tij, të cilat e

bënë të zëjë një vend shumë të rëndësishëm në repertorin pianistik botëror. John Dëight, një kritik lider e Bostonit e pranoi që koncerti i Çajkovskit ishte brilant dhe eksitues, dhe shtoi: "A thua do të mësohemi ta admirojmë një muzikë të tillë?"

Dhe, koncerti i Çajkovskit, filloi të dëgjohet nëpër Europë. Mbas vlerësimit kritik të njohur Vinez, Hanslick, reputacioni i Çajkovskit u ngrit me shpejtësi. Mirëpo është interesante se në Moskë, piano-koncertin No.1 në Si b minor e dirigjoi Nikolaj Rubinshtein ndërsa në piano luajti Sergej Tanjejev. Rubinshtein e ka luajtur atë piano-koncert disa herë dhe ai u bë koncerti shumë popullor. Koncertet dhe pjesët e tipit koncertal për piano, violinë dhe violonçelo për orkester, që lidhin pasurinë dhe qartësinë e materialit me hapësirën e virtuoziçitetit dhe dimensionin simfonik, u bënë veprat muzikore më të shquara jo vetëm në Rusi por në një shkallë të konsiderueshme edhe në artin muzikor botëror. Nga tre koncertet e pianos, koncerti No.1 i Çajkovskit ishte më brilanti. Ai vinte i fuqishëm, plot lirizim, me pasuri ngjyrash dhe me melodi patetike-romantike. Elementet e virtuoziçitetit dhe ato të teknikës për pjesën e pianos, pasqyrojnë pastër "trupin dhe gjallërinë e punimit" (Boris Asafjev). Orkestra dhe solisti në piano luajnë si dy partnerë të barabartë, por që luftojnë me njëri-tjetrin, konkurojnë me tyre dhe harmonikisht e mbështesin njëri-tjetrin.

Po tjetër për koncertin

Kisi-Karajan?

Më 1988, Kisi takohet me Herbert Karajanin për interpretimin e piano-koncertit të Çajkovskit. Hyrja e Kisiut në skenë dhe afrimi me dirigjentin ishte e qetë dhe si e papritur. Impresario i tij, Hans-Dieter Gohre e ftoi Kisiun dhe familjen e tij të qëndrojnë në Munich para se të fillonte turin e tij në Austri dhe Zvicër, me 'Virtuoze të Moskës'. Në mëngjes Gohre e thirri pianistin e ri dhe bisedoi me të për koncertin e Berlinit. Karajani, pasi kish parë rregjistrimet e Kisiut që ia kish dërguar ky, ishte dakord që të dirigjonte koncertin e pianos me Kisiun. Evgenij Kisi mbante mend detajet e çdo minute të takimit me Karajanin si dhe efektin e jashtëzakonshëm të dirigjentit mbi të: "Anna Pavlovna Kantor, më tha mua që nuk e kisha luajtur asnjëherë 'Fantazinë e Shopenit' që e kisha bërë gati për Karajanin"- tha pianisti i ri. Efekti ishte i dukshëm i dyanshëm. "Kur mbarova së luajtur në piano, kujtohet Kisi, "ia hodha sytë Karajanit, bëra disa hapa drejtë tij dhe ai më dha një të puthur, hoqi syzet dhe fshiu lotët me një shamë dore". E shoqja e Karajanit i tha pianistit Kisi mbas takimit: "Jam martuar më të tash 30 vjet por asnjëherë nuk e kam parë atë në këtë gjendje të thellë emocionuese". Evgenij Kisi, është një talent i jashtëzakonshëm në piano. "Unë studioj më tepër se 5-6 orë në ditë sepse talenti nuk mund të realizohet pa punuar. Kur ishte në majën e talentit të tij, pianisti Amerikan, Van Cliburn, fitoi Konkursin Ndërkombëtar "Çajkovski" për piano, me piano-koncertin No.1 op.23 në Si b minor dhe ky

është shembull i qartë i asaj që, pa punë, talenti mjerisht mbetet një asgjë".

Aleksander Borisoviç Goldenvazer tha për pianistin Kisi: "Ky djalo kur luan në piano, bisedon me Zotin".

Kisi afrohet me Anna Pavlovna Kantor e cila ishte pedagoze nga më të mirat për fëmijët në shkollën e muzikës Gjnesin të Moskës. Ai shpjegon: "Isha 6 vjeç. Njëra nga shoqet dhe koleget e nënës time, jepte mësim në fortepiano në shkollën e muzikës Gjnesin. Ajo ishte e martuar me pianistin dhe pedagogun e njohur të Moskës, Evgenij Liberman i cili nuk merrej me mësimin e fëmijëve në shkollën e pianos. Atëherë ai më foli për Anna Pavlovna, njëra nga pedagoget më të mira të fëmijëve në Moskë, organizoi takimin pa i treguar prindërve të mi të cilët atë kohë nuk donin që unë të bëhesha muzikant. Derisa mora ime mësonë muzikë, ata e dinin se sa punë e vështirë ishte dhe menduan që unë duhet të merresha me diçka tjetër. Ata menduan që unë duhet të shkoja për të mësuar anglisht pesë herë në javë. Mirëpo, takimi i organizua në atë mënyrë që prindërit pasi u bindën, më dërguan në shkollën e muzikës Gjnesin të Moskës (shkollë e themeluar nga tri motrat Gjnesin-sionim i përsosurisë në muzikë dhe disiplinë)".

Kisi, sipas legjendës, qysh kur ishte 11 muajsh, filloi të përsërit tonet e Bah-ut të cilat i luante në piano motra e tij. Sa filloi të ecë, i shtriu gishtërinjtë mbi tastet e pianos duke u përpjekur të luante melodi të cilat i kish dëgjuar në radio. Për fëmijë të tillë në Moskë ekzistonte vetëm shkolla Gjnesin. Kisi mësosi shkëlqyeshëm me Anna Pavlovna e cila u bë pjesë e familjes Kisi. Kjo bashkë me të ëmën e pianistit e shoqëronin gjeniuin e thjeshtë romantik nëpër vendet jashtë Rusisë ku kishte koncerte. Talenti i pianistit Kisi shpërtheu në vitin 1984, kur ai interpretoi dy piano-koncertet e Shopenit me Orkestrin e Filarmonisë së Moskës.

"Fillova ta luaj muzikën në piano me vesh, pa partiturë. Ishin dy gjëra të rëndësishme për mua, në fillim ta dëgjosh muzikën dhe menjëherë ta luaj në piano. Kështu ekzekutova në piano 'Ballaten e Shopenit', 'Rapsodinë No.12 të Lishtit, ndërsa nëna i tha Pavlovna's që unë e dua improvizimin e muzikës time. Në Gjnesin qëndrova 12 vjet. Gjatë kësaj kohe familja e jonë u afërua shumë me Annën e cila të gjithë jetën e saj ia kushtonte nxënësve të vet". Pianisti i famshëm

Rus Kisin (45) mbetet një pianist me një karrierë mahnitëse, ai tashmë konsiderohet një interpretues legjendar në piano. Në tri dekada, që prej përfqimit të monumenteve të repertorit pianistik, që prej Shopenit, me të cilin për herë të parë bëri emër, e deri te thellësitë emocionale të Shumannit dhe të virtuozeve të pastër të Lisit, Evgenij Kisin shkëlqeu dhe u bë një nga muzikantët më të shquar e më të rëndësishëm të kohës sonë. Evgenij Kisin e interpretoi piano-koncertin e Çajkovskit edhe në Boston mbas 110 vitesh që prej premierës së koncertit me pianistin Hans von Bülow.

Në muzikën instrumentale është e rëndësishme që të kuptohet se si kompozitori do t'a donte që t'i interpretohej muzika e tij. Kështu Çajkovski patjetër interpretohet ashtu siç e shkroi muzikën e tij të piano-koncertit No.1, pra vetëm në mënyrën 'çajkovskiane' dhe siç pothot legjendari Yehudi Menuhin, të gjithë instrumentistët Rus janë të admirueshëm në teknikën dhe temperamentin e tyre dhe se veprat e autorëve të vendit të vet ata i interpretojnë më mirë nga të tjerët. Dhe shton më tej: "Çajkovski mbetet një gjigand, ai preku zemrën humane. Unë e ndiej muzikën e tij baletike prej së largu, ai ishte shumë elegant dhe kompozitor aristokratik. Çajkovski ishte nga ata pak Rusë të kohës së tij që e adhuron Mozart. Kisha kënaqësi kur dirigjova simfoninë e tij No.4,5 dhe 6".

Dhe Menuhin, kish shumë të drejtë kur vlerësoje muzikën e bukur baletike të Çajkovskit i cili thoshte që, kushti parësor i çdo krijimi artistik është bukuria. Muzika e Çajkovskit është plot lirizëm, e pastër, e kthjellët dhe magjepsë.

Andrej Gavrilov, pianist e dirigjori Rus shton: "Asnjë tjetër kompozim klasik nuk interpretohet kaq shpesh si piano-koncerti No.1 në Si b minor, jo vetëm në performancat publike, por edhe në konkurset ndërkombëtare të pianos. Një interpretim i shpeshtë i koncertit i ndjekur me admirim e delikatesë nga publiku, e ka bërë këtë koncert të jetë brilant e madhështor. Ky piano-koncert, filozofi simfonike e jetës, me modulime melodike të shpirtit të njeriut, është ekzistencializmi simfonik i ëmbël Rus që i përket dhjetësheve të veprave më të mira të krijuara prej genit njerëzor. Për interpretimin e piano-koncertit No.1 të P.I.Çajkovskit duhet të jeshë jo vetëm një pianist me teknikë të përsosur por edhe të kesh përvojë të pasur, të njohësh mirë kulturën Ruse të shek.19 por edhe ta kuptosh thellë filozofinë religjioze Ruse ose siç e quajmë ndryshe, zgjuarsinë organike të jetës".

Çajkovski, duke punuar mbi piano-koncertin No.1, u orientua nga pianizmi madhështor i Nikollaj Rubinshteinit, në artin e ekzekutimit të të cilit, virtuozeve i lartë, vruilli dhe forca sigurojnë të dëgjuesi një veprim të pakthyeshëm.

Sa për kujtesë, në vitin 1880, Çajkovski vendosi t'ia dedikojë piano-koncertin No.2 pianistit Nikollaj Rubinshtein për interpretim të jashtëzakonshëm të piano-koncertit No.1. Koncerti i pianos në Si b minor përmban teknikë pianistike të përsosur përveç pasazheve, oktavave, akordeve masive, por gjithashtu episode lirike, qartësi, kthjellësi dhe ekspresion të thellë. Çajkovski shfrytëzoi ciklin e trekohësish klasik për koncertin por duke krijuar një koncept krejtësisht novator. Pjesa e parë, 865 masa, 23:41, ka një hapje ikonike,

madhështore, që zor se mund të gjendet te ndonjë koncert tjetër. Fillon me katër kornot e stuhishme dhe me tetë akordet në Si b minor të orkestrës që lajmërojnë temën lirike dhe pasionante në Re b maxhor të introduksionit. Tema dëgjohet tri herë, orkestra-piano-orkestra dhe nuk shfaqet më deri në përfundimin e 'allegro con spirito'. Kjo pjesë është e pasur me fantazi krijuese, me kontraste të guximshme e të papritur, me kulmime të fuqishme, me ngritje të fuqishme dramatike dhe momente të qetësisë, në mbarim të cilave arrihet përfundimi madhështor triumfes mbas shumë përpjekjesh.

Andantino semplice, 170 masa, 8:33, është shkruar në formën tripjesëshe, në Re b maxhor dhe është një nga lirizmat më të bukur të Çajkovskit. Mbas një introduksioni shumë të shkurtër të pizzicatove, flauti ekspozon temën të shoqëruar nga pizz. e harqeve me një ngjyrim pastoral që gradualisht zotëron karakter më ekspresiv. Më pas, edhe violonçelo, oboe dhe piano përsërisin temën e bukur. Çajkovski bashkoi linjat e dy pjesëve të ciklit simfonik tradicional-pjesën lirike dhe scherzo. Në të gjithë pjesën e dytë, një rëndësi të madhe paraqet forma-variacioni e zhvillimit të materialit tematik. Finalja e piano-koncertit, allegro con fuoco, 301 masa, 8:46, në Si b maxhor, është energjike dhe sjell një impresion të madh dhe entuziazëm të dëgjuesit. Kjo finale, ashtu si në të gjithë punimet simfonike të mëdha të Çajkovskit, paraqet daljen nga sfera e brendshme shpirtërore, në botën e zhurmshe, plotngjyrshme të gëzimit popullor. Për temën bazë të finales, Çajkovski shfrytëzoi melodi të njohura Ukrainase por që i ndryshoi duke i shtuar karakterin e "tokatës" ritmike që më të shumtën, ishte tipike për këngë dansi. Kësaj teme i kontrastohet e dyta, lirike, gjërësisht e këndueshme. Të dy temat në kontrast, nuk i nënshtrohen përpunimit, por thjeshtë alternohen në atë vazhdimësi për të cilën, tema e parë ruan të pandryshueshme formën e ekspozicionit dhe tonalitetin kur tema e dytë, e ndryshon tonalitetin e saj. Kjo finale është shkruar në formën rondo-sonata, që haset edhe në literaturën koncertale të shek.19. Kjo formë e Çajkovskit interpretohet me interes dhe origjinalisht: në këtë rast formohen si të thuash, tre cikle të vegjël analogë, të përbërë nga alternimi i disa formave. Në ciklin e fundit inkludohet Coda e karakterit triumfes.

Piano-koncerti No.1 në Si b minor op.23 i Çajkovskit sot konsiderohet si një nga numrat kyç të repertorit pianistik të pjesës më të madhe të koncert-pianistëve në botë. Vetëm shikojeni ndryshimin midis "Emperorit" të Beethovenit dhe "Emperorit" të Çajkovskit në interpretimet e pianistit Evgenij Kisin, dhe ska nevojë për koment. A thua, ashtu siç thoshte Nurejevi i famshëm që çdo balet-danser, çdo mëngës, duhet të përkulet para portretit të Çajkovskit, këtë gjë duhet ta bëjnë edhe pianistët para partiturës së tij?

Herbert von Karajan, gjeti te Evgenij Kisini, interpretuesin më të dëshirueshëm të tij, më të mirin, për piano-koncertin No.1 të P.I.Çajkovskit. Sot, piano-koncerti No.1 i P.I.Çajkovskit është një nga produksionet më të ekzekutuar në repertor. Veçanërisht ai tingëllon shumë shpesh gjatë ditëve të Konkurimit Ndërkombëtar "Çajkovski" në Moskë.

LETËRSIA

Mik i panelit ishte Arian Leka, poet dhe redaktor i revistës "Poeteka" dhe profesor në Fakultetin e Artit në Tiranë dhe me të diskutuan Milosh Zhivanoviç dhe Sasha Ciriç, redaktorët e shtojcës së angazhuar letrare dhe portalit "Beton". Arsyeya e realizimit të kësaj interviste ishte e veçantë pasi edicioni i qershorit të 'Beton'-it është dedikuar për letërsinë bashkëkohore nga Shqipëria, e cila është përgatitur nga Arian Leka, që shkroi edhe një parathënë për të. Për këtë edicion është botuar edhe nga një pjesë edhe prej Mira Meksit, Ardian Kuçukut dhe Ylljet Aliçkajt, që janë përkthyer nga Anton Berisha, e janë botuar gjithashtu edhe poezi nga Sabina Veizaj, Lindita Arapi dhe Maringlen Niço, në përkthimin e Shkëlzen Maliqit.

Një copëz Shqipërie arti në Beograd



Arian Leka




Luljeta Leshanaku

Ditët e fundit, Shoqata e Kulturës "Parobrod", ka mbajtur një panel diskutimi me titullin "Letërsia e panjohur nga Shqipëria", e cila është organizuar nga Lëvizja Evropiane në Serbi. Ngjarja kulturore është pjesë e projektit të "Qendrës së Përbashkët për marrëdhëniet shqiptaro-serbe", të cilën e kanë nisur si projekt Forumi për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Lëvizjes Evropiane në Serbi dhe Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare në Tiranë me mbështetjen e granteve të Republikës Federale të Gjermanisë.

Mik i panelit ishte Arian Leka, poet dhe redaktor i revistës "Poeteka" dhe profesor në Fakultetin e Artit në Tiranë dhe me të diskutuan Milosh Zhivanoviç dhe Sasha Ciriç, redaktorët e shtojcës të angazhuar letrare dhe portalit "Beton". Arsyeya e realizimit të kësaj interviste ishte e veçantë pasi edicioni i qershorit të Betonit është dedikuar për letërsinë bashkëkohore nga Shqipëria, e cila është përgatitur nga Arian Leka që shkroi edhe një parathënë për të. Për këtë edicion është botuar edhe nga një pjesë edhe prej Mira Meksit, Ardian Kuçukut dhe Ylljet Aliçkajt, që janë përkthyer nga Anton Berisha, e janë botuar gjithashtu edhe poezi nga Sabina Veizaj, Lindita Arapi dhe Maringlen Niço në përkthimin e Shkëlzen Maliqit.



Bashkim Shehu



Fatos Kongoli

Fokusi i diskutimeve ka qenë çështja e përkthimit të ndërsjellë në dekadat e fundit, nga gjuha shqiptare në atë serbe dhe anasjelltas, gjatë të cilit i intervistuari përmendi edhe ecurinë e Shqipërisë në revistën e vogël të letërsisë në klubin "Books" në Zagreb në vitin 2014 dhe antologjinë e prozës dhe poezisë shqiptare "Kaplje", botuar vitin e kaluar në Mal të Zi. Janë përmendur edhe përkthime të shkruarëve modernë shqiptarë bërë në gjuhë serbe, siç janë pjesët e Ismail Kadaresë, Bashkim Shehut, Anilda Ibrahimit, Ridvan Dibrës, Luljeta Leshanakut, Zija Çelës dhe të tjerët, duke konstatuar se letërsia shqipe nuk përkthehet shumë, kurse ekziston

nevoja për përkthim të ndërsjellë. Paneli diskutoi dhe përkthimin e librave nga autorët kosovarë shqiptarë dhe gjenden e përkthimit të tyre me përfundimin se ka një nevojë për një numër më të madh të përkthyesve të rinj dhe redaktorëve.

Paneli u ndoq nga studentët e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Fakultetin Filologjik në Beograd me profesor Naile Imamin, përfaqësues të ambasadës shqiptare në Serbi, përkthyes të vjetër të tillë si Hamdi Ukaj, i cili ka përkthyer edhe Kim Mehmetin dhe Fatos Kongolin por edhe shumë vizitorë të interesuar në marrëdhëniet serbo-shqiptare në kulturë.

(Marrë nga Beton)

D

DOKUMENT

NGA AVNI ALCANI

Rreth 21 vite më parë, në mediat e shkruara shqiptare u bë e njohur një stemë heraldike e vitit 1464, e cila ishte zbuluar në Bibliotekën Marciano të Venecias nga studiuesja e njohur italiane, Prof. Dr. Luçia Nadin (Itali). Emblema u gjend në një katalog stemash heraldike, të cilat ishin kopje të një dorëshkrimi të shekullit 15-të. Stema u publikua për herë të parë në revistën "Brezi 9" (Tetovë 1996), me titull "Stema e Aranitëve",¹⁾ e autorëve Luçia Nadin dhe Jaho Brahaj. Stema është e vizatuar në formën e një shqyti (mburoje) me figurë ku paraqitet një shqiponjë me dy krerë me ngjyrë të verdhë, e vendosur mbi një sfond në ngjyrë blu. Një vit më pas emblema u përfshi në librin "Emblemat shqiptare" (Tiranë 1997), të autorit J. Brahaj,²⁾ dhe pas disa vitesh në librin "Immagini e dokumenti della biblioteca nazionale...", të autorës L. Nadin.³⁾ Zbulimi i kësaj steme heraldike ishte shumë i rëndësishëm për historinë dhe kulturën kombëtare, pasi e pasuroi heraldikën shqiptare me një stemë të re, që i përkiste Familjes Princërore të Aranitëve, njëres prej familjeve më të mëdha dhe më të rëndësishme të historisë shqiptare në shek. e 15-të.

Ajo që tërheq vemendjen e stemës është një tekst i shkurtër që e shoqëron atë, në të cilën, e përkthyer në shqip, lexohet: "*Komino i derës së Zotit Retini të Shqipërisë mbi Skuteri, Zot në anët e atij vendi, i cili u pranua dhe u bë antar i Këshillit të Madh, sepse kështu u duk me vend Sinjorisë sonë për ta nderuar dhe për ta patur simpatizant tonin. Kjo u bë në vitin 1464*".⁴⁾ Dy autorët e botimit të stemës në artikullin e tyre shkruajnë se kjo emblema i përkiste familjes së njohur arbërore të Aranitëve dhe se pas emrit Komino janë tre djemtë e Gjergj Aranitit.⁵⁾ Por a ishte Komino i dokumentit të mësipër njëri nga djemtë e Gj. Aranitit? Disa të dhëna në lidhje me zotërimet e pronave të Aranitëve në vendin e quajtur "mbi Skuteri", na shtojnë të mëtejshme se Komino i dokumentit të mësipërm nuk ka qenë djali i Gj. Aranitit, ndaj është shumë e rëndësishme që të zbulojmë, së pari, se kush ishte ky Komino, që ishte pranuar antar i Këshillit të Madh të Venedikut në vitin 1464 dhe, së dyti, kush person fshihej pas emrit "Retini të Shqipërisë".

Të marrim në analizë emrin Komino, për të parë nëse ai i përkiste një emri të familjes Araniti. Historianët që janë marrë gjërgjësisht me origjinën e emrit Araniti, shkruajnë se kjo familje në shek. e 15-të zotëronte disa emra, si: *Araniti, Komneni, Golemi, Topia, Spada, Çermenika* etj.⁶⁾ Prof. Dhimitër S. Shuteriqi, një nga njohësit dhe studiuesit më në zë të familjes Araniti, ka shkruar se

Shtrohet përsëri pyetja se cili ishte ky Komino, që ishte pranuar antar i Këshillit të Madh të Sinjorisë? Zgjidhjen e kësaj pyetjeje do ta gjejmë të dokumenti që shoqëron emblemen, ku kemi një detaj shumë interesant e të rëndësishëm, i cili do të na çojë në zbulimin e enigmës sonë. Aty shkruhet: "Komino i derës së Zotit Retini të Shqipërisë mbi Skuteri, Zot në anët e atij vendi" (nënvizimi im-A.A.), që do të thotë se ky Komino ishte zot jo në Skuteri, por mbi të...

Kush ishte Komino, që në vitin 1464 u pranua antar i Këshillit të Madh të Venedikut?

"kur emrat Aranit, Komnen dhe Golem i gjejmë dy nga dy ose të tre sëbashku, atëherë mund të themi me mjaft siguri se kemi të bëjmë me familjen e famëshme (Araniti)".⁷⁾ Emri Komnen i familjes gjendet i shkruar në dokumente të ndryshme edhe me variantet: *Cominatus, Comninno, Connon-euili, Cominovich, Cominati, Comino, Comneno* etj.⁸⁾ ndaj emri Komino (Comino) i dokumentit që po trajtojmë, është lehtësisht i vërtetueshëm që lidhet me një Aranit.

Emri Retini paraqitet pak më i vështirë për t'u identifikuar, pasi del për herë të parë në një dokument me këtë emër. Shuteriqi, kur merr në analizë emrin Araniti, sjell disa variante të tjera të tij, të cilat kanë dalë në dokumenta të ndryshme, si *Araniti, Arayniti, Arniti, Arnith, Arriani, Harryajniti, Harianites* etj.⁹⁾ Emri Retini nuk është hasur si i tillë në asnjë rast, as në dokumenta të kohës e as në shkrimet dhe studimet e autorëve të ndryshëm. Variantet e emrave "Araniti" dhe "Komnen" janë shkruar nga hartuesit e huaj të këtyre dokumenteve, të cilët, duke mos qenë emra të njohur për ta, nuk kanë mundur që t'i shqiptojnë dhe t'i shkruajnë drejt ato. Edhe në këtë rast emri Retini është i shkruar gabim. Ai është një shtrembërim i variantit të emrit Araniti për *Areaniti* apo *Arniti*.

Pas emrit Retini qëndron Gjergj Aranit Komneni. Ai ka qenë figura kryesore e familjes gjatë shek. të 15-të dhe kreu i "derës" së Aranitëve. Për bëmat dhe kryengritjet e tij ngadhënjimtare kundër osmanëve, Gj. Araniti ishte bërë i njohur jo vetëm Venedik e në qytetet e tjera të Italisë fqinje, por edhe në mbretëritë e kancelaritë e mëdha europiane. Në të njëjtin dokument flitet edhe për një tjetër stemë heraldike, e cila i përkiste familjes Kastrioti. Në tekstin që shoqëron emblemen shkruhet se emblema i përket një të quajtur "Kastriotas", i cili ishte pranuar gjithashtu antar i Këshillit të Madh të Venedikut.¹⁰⁾ Aty shënohet edhe emri i Gjergj Kastrioti Skënderbeut si figura qëndrore e familjes Kastrioti, që në dokument quhet i "shtëpisë së zotit Skanderbeg", i cili, ashtu si Gjergj Araniti për fisin e Aranitëve, njëjti dhe nderohet nga të gjithë si kreu i fisit Kas-



Busti i Gjergj Aranitit në Librazhd

trioti, si brënda ashtu dhe jashtë Arbërisë.

T'i rikthehemi përsëri emrit Komino për t'u përgjigjur pyetjes sonë se cili Aranit qëndron prapa këtij emri. Komino i mësipërm nuk mund të ketë qenë Gjergj Aranit Komneni, pasi burimet historike thonë se ai kishte vdekur para vitit 1464,¹¹⁾ vit në të cilin Komino i dokumentit të mësipërm ishte pranuar antar i Këshillit të Madh të Venedikut. Por as djemtë e Gj. Aranitit nuk mund të kenë qenë, siç pretendojnë dy autorët e publikimit të emblemes, të cilët shkruajnë se me emrin Komino lidhen tre djemtë e Gjergj Aranitit,¹²⁾ pasi në dokument nuk shkruhen tre, por vetëm një emër. Në një dokument të mëparshëm të po atij viti, i cili mban datën 13 maj 1464, janë shënuar emrat e tre djemve të Gj. Aranitit, Thomai, Kostandini dhe Araniti ishin

Pas emrit Retini

Pas emrit Retini qëndron Gjergj Aranit Komneni. Ai ka qenë figura kryesore e familjes gjatë shek. të 15-të dhe kreu i "derës" së Aranitëve. Për bëmat dhe kryengritjet e tij ngadhënjimtare kundër osmanëve, Gj. Araniti ishte bërë i njohur jo vetëm në Venedik e në qytetet e tjera të Italisë fqinje, por edhe në mbretëritë e kancelaritë e mëdha europiane. Në të njëjtin dokument flitet edhe për një tjetër stemë heraldike, e cila i përkiste familjes Kastrioti. Në tekstin që shoqëron emblemen shkruhet se emblema i përket një të quajtur "Kastriotas", i cili ishte pranuar gjithashtu antar i Këshillit të Madh të Venedikut

shpallur "nobili", d.m.th., fisnikë të qytetit të Venedikut dhe ishin marrë në mbrojtje nga Sinjoria.¹³⁾ Në dokument, i cili është publikuar nga historiani gjerman Babinger ("Fundit i aranitëve", Tiranë 2004), shkruhet: "*Thomas Comino, Constandinus et Areniti fra(tr)es, d(omi)ni in patribus Albanie, figli quondam M(agnifici) et potentis d(omi)ni Areaniti*".¹⁴⁾ Por as njëri prej tyre, si, p.sh., Toma Araniti, i cili ishte djali më i madh i Gj. Aranitit, nuk mund të ketë qenë, pasi ai ishte ende i mitur dhe, për shkak të moshës, ishte i pa aftë që të mbante mbi supë misionet e rëndësishme politike, ushtarake e diplomatike. Një vit më parë (1463), shkruan F. Babinger, nëna

e tyre Despina Araniti i ankohej Këshillit të Madh të Sinjorisë për Skënderbeun, për shkak se ky i fundit i pati kërkuar që djali i saj i madh, Thomai, që ishte ende i mitur, të shkonte për të luftuar te Sulltani.¹⁵⁾ O. Schmid, autori i librit "Skënderbeu" (Tiranë 2009), shkruan se: "*Thoma Araniti një herë për njëherë as që nuk mbahej në konsiderat si aleat, në vend të tij doli në pah e jëma...*".¹⁶⁾ Dhe vërtetë, ishte nëna e tyre Despina Araniti, e cila tre vjet më vonë, dhe pikërisht në vitin 1467, do t'i drejtohej për ndihmë Sinjorisë për të luftuar kundër osmanëve, duke dërguar atje njërin nga vasalët e saj, Ilia Bosin, i cili, në emër të zonjës së tij, lidhi marrëveshje të rëndësishme me Venedikun.¹⁷⁾ Një vit më parë, më 15 shtator 1463, Këshilli i Madh i Venedikut kishte përmbyshur edhe një kërkesë të Skënderbeut për të pranuar djalin e tij, Gjonin, në radhët e aristokracisë së Venedikut.¹⁸⁾

Atëherë shtrihet përsëri pyetja se cili ishte ky Komino, që ishte pranuar antar i Këshillit të Madh të Sinjorisë? Zgjidhjen e kësaj pyetjeje do ta gjejmë të dokumenti që shoqëron emblemen, ku kemi një detaj shumë interesant e të rëndësishëm, i cili do të na çojë në zbulimin e enigmës sonë. Aty shkruhet: "*Komino i derës së Zotit Retini të Shqipërisë mbi Skuteri, Zot në anët e atij vendi*" (nënvizimi im-A.A.), që do të thotë se ky Komino ishte zot jo në Skuteri, por mbi të. Skuteri-a, apo Skuterra e sotme, është një fshat pranë Mushqetësë në krahinën e Kerrabës së Tiranës, që ndodhet në krahun e majtë të lumit Erzen. Mbi Skuterë, atje ku buron edhe lumi i Erzenit, ndodhet krahina e Tomadesë. "Në mesjetë", shkruajnë dy autorët Nadin dhe Brahaj, "Skuterra ishte kufiri që ndante qytetin krahinës dhe Tomadhesë".¹⁹⁾ Në regjistrin kadastral Osman të vitit 1467, të Vila-jetit të Dibërës, Dulgoberdës, Rijekës dhe Çermenikës, Tomadhe emërtohej si "Krahina e Tamadhesë".²⁰⁾ Skuterra e ka një kufi krahinës e Tomadesë, kurse krahinën e Çermenikës e ka shumë larg prej saj. Çermenika shtrihet në jug të krahinës së Tomadhesë dhe zbrit deri në luginën e lumit Shkumbin.

Lind pyetja: Kush kishte qenë Komino që kishte zotëruar fshatrat e Tomadesë në shek. e 15-





të, para pushtimit të tyre në vitin 1467 nga osmanët? Dy autorët Nadin dhe Brahaj në artikullin e tyre të përmendur lenë të kuptohet se janë bijtë e Gjergj Aranitit. Çermenika, shkruajnë ata, kishte qenë në zotërim të Gj. Aranitit dhe bijve të tij dhe se ajo (Çermenika) ishte qendra e princit Gjergj Araniti.²⁰ Por, a është e vërtetë se Gj. Araniti dhe bijtë e tij i kishin pasur në zotërim dy krahinat, të Çermenikës dhe Tomadësë, dhe se Çermenika kishte qenë qendra e zotërimeve të tij? Burimet historike flasin krejt të kundërtën, që Gj. Araniti dhe bijtë e tij nuk i kanë pasur në zotërim të gjitha fshatrat e Çermenikës dhe veçanërisht fshatrat e Tomadësë. Historianët shkruajnë se disa nga pronat e Gj. Aranitit ndodheshin në jug të krahinës së Çermenikës, në luginën e lumit të Rrapunit. Sipas historianit gjerman Franc Babinger, një nga njohësit më të mirë të Aranitëve, i cili shkruan se “Gjergj Araniti, duhet të ketë qenë rreth viteve 1443 zot i Çermenikës (në skajin jugor të malësisë, në territorin e Rrapunit), i pjesëve nga Mokra dhe Shpati...”²¹ Prof. Dhimitër S. Shuteriqi i shtyn edhe më në jug pronat e Gj. Aranitit, kur shkruan në artikullin e tij “Aranitët. Zotërimet” (Tiranë 1967), se “Gj. Araniti i kishte zotërimet në pjesën qëndrore dhe jugore të viseve ku sundoi familja e tij në Çermenikë, Polli-Gukës dhe Mokër. Zotërimet e tij kufizoheshin, po edhe përzjeheshin me ato të Muzakës, vëllait të tij, dhe, me sa duket, ishin kryesisht nga ana e majtë e Shkumbinit (Shënimi im-A. Alcani)”²² Prof. Shuteriqi, në studimet e tij për Aranitët, shkruan se Polisi ishte kryeqendra e Gj. Aranitit. Në një artikull kushtuar viseve të Aranitëve në vitin 1467, të cilat i quan “Aranitia”, ai shkruan se Polisi “ishte kryeqendra e Gjergj Aranitit dhe e pasardhësve të tij, me kështjellën në Kryekorrë (Crepakore-Krepi i Korrës), midis Vilanit e Sopotit të sotëm”,²³ duke na dëshmuar se Çermenika nuk ka qenë kryeqendra e zotërimeve të tij.

Kush Araniti i zotëronte fshatrat e Çermenikës dhe Tomadësë? Kronisti Gjon Muzaka shkruan se disa nga fshatrat e krahinave të Çermenikës dhe Tomadësë i zotëronte Muzak Komneni, i cili ishte nipi i Gjergj Aranitit, nga vëllai i tij Vladan Komneni. Në “Memorien” e tij kronisti Gj. Muzaka shkruan se “Muzak Komneni, që thirrej nga populli i Angjelinës, kishte një kështjellë që quhej Bieshka (Biescha) dhe mjaft fshatra të tjerë që janë në Çermenikë dhe Tomadhi”²⁵ Muzhaq Komneni, sipas Barletit, “thirrej edhe me mbiemrin Golem Araniti...”²⁶ Duhet të kemi parasysh se Gjon Muzaka ishte një njohës i mirë i familjes Araniti, për shkak të lidhjeve të krushqisë që

kishin dy familjet mes tyre.²⁷

Dëshmia e Gjon Muzakës, se Muzhaq Komneni kishte qenë “Zot” i fshatrave të krahinës së Tomadhesë “mbi Skuteri”, ka zgjidhur përfundimisht enigmën se Araniti me emrin Komino, që përmendet në dokumentin e stemës heraldike të Aranitëve dhe që ishte pranuar si antar i Këshillit të Madh të Venedikut, ishte Princi arbëror Muzhaq Komneni, djali i Vladan Komnen Aranitit.

Pas vdekjes së Gjergj Aranitit, aleatit më të madh dhe më të rëndësishëm të venedikasve, figurat më me emër të madh në familjen Araniti ishin Moisi Golemi, Muzhaq Komneni dhe vëllai i tij Gjeric Vladani, të cilët ishin gjenralët dhe kapedanët më të shquar të ushtrisë së Skënderbeut. Dokumenti që kemi përpara është një dëshmi e qartë se venedikasit kishin pasur interesa dhe dëshironin që, pas vdekjes së Gjergj Aranitit, t’i vijonin politikat e tyre të afirmimit me pasardhësit e Aranitëve. Nuk janë ende të njohura motivet se përse venedikasit kishin zgjedhur pikërisht Muzhaq Komnenin për ta pasur aleatin e tyre. Sipas mendimit tonë, arsytet duhen të kishin qenë, së pari, se Muzhaqi kishte qenë një kapedan i sprovuar i ushtrisë së Skënderbeut dhe besnik i këtij të fundit, së dyti, se ai ishte në lidhje gjaku me dy prej lidërve më të shquar të kryengritjes anti-osmane të shek. të 15-të dhe aleatët më të mëdhenj të venedikasve, me Gjergj Aranit Komnenin dhe Gjergj Kastriot Skënderbeun. Ky i fundit e kishte Muzhaqin nip nga motra e tij, Angelina Kastrioti.

Dokumenti i mësipërm dëshmon edhe një herë për rëndësinë e madhe që i kushtonin venedikasit aleancave me familjen e madhe të Aranitëve, si dhe për personalitetin e Muzhaq Komnenit, që ai e gëzonte jo vetëm të klasa e aristokracisë arbërore, por dhe të aleatët e mëdhenj e të rëndësishëm, siç ishte Republika e Venedikut, një nga shtetet më të fuqishme europiane të kohës.

1) Nadin, Brahaj 1996: Revista “Brez 9” (korrësi) Tetovë, faqe 36.
2) 1997: Emblema shqiptare, faqe 39-41 dhe 43-45.
3) Nadin: Imagjini e dokumenti della biblioteca nazionale..., faqe 25.
4) Nadin, Brahaj 1996: Po aty, faqe 36.
5) “A është fjala për Aranitët në dokumentin tonë që i përkasin vitit 1467? Dime se kishte vdekur Gjergj Araniti para këtij viti dhe kishte lënë tre djem”. Po aty, faqe 36.
6) Shuteriqi 1965: Aranitët, Emri dhe gjenealogjia, faqe 5-4.
7) Shuteriqi 1965: faqe 8.
8) Shuteriqi 1965: faqe 3-4.
9) Shuteriqi 1965: faqe 4.
10) Brahaj 1997: faqe 43.
11) Gjergj Araniti duhet të ketë vdekur tashmë që në vjeshtë të vitit 1468...”, Babinger 2004: Fundi i Aranitëve, faqe 26.
12) Po kështu, kur bëhet fjala për djemët e Gjergj Aranitit në fund të shek. XV dhe në fillim të shek. XVI, ata si mbiemër kanë Komino”, Nadin, Brahaj 1996: Art. i cituar.
13) Shmid, 2009: faqe 3.
14) Babinger 2004: faqe 27.
15) Babinger 2004: faqe 28.
16) Shmid, 2009: faqe 198.
17) Shuteriqi 1965: Dy dokumente të kohës së Skënderbeut, gazeta “Drita”.
18) Babinger 2004: Po aty, faqe 26-27.
19) Nadin, Brahaj 1996: faqe 36.
20) Arkivi i Institutit të Historisë: Defteri emëror..., faqe.
21) Çermenika ishte qendra e princit Gjergj Araniti”, Nadin, Brahaj 1996: faqe 36.
22) Babinger 2004: faqe 17.
23) Shuteriqi 1967: faqe 71.
24) Shuteriqi 1967: faqe 135.
25) Muzaka 1996: faqe 36.
26) Barleti 1985: faqe 402.
27) Muzaka 1996: faqe 35, 36 dhe 37.

POEZIA

NGA SAZAN GOLIKU

PROMETEU

Pasi kaloi skëtërrën e mbitokës e të nëntokës pasi përbuzi e mohoi thesaret e tokës e të qiellit pasi shpërtheu zinxhirit e fatit të parathënë me zjarrin rrëmbyer Zeusit të madh rufehedhës

Prometeu qëndroi kryelart para njerëzve e vetes.

Zjarrin mitik iu shndërrua në monedhë të artë që rrezatonte si Dielli.

E kush e meriton më tepër se unë! – thirrri sa u trand tokë e det i pavdekshmi Promete

dhe e futi monedhën në honin pa fund të xhepit të vet.

DEHJE

Buzëdetit mes dallgëve e shtrirë lakurik me bërrylat mbi zajet e bardhë farfuritës ajo përplaste këmbët dhe ujët shumëzonte gëzueshëm.

Nga sipër kundroja, i dehur bukurie sytë e saj dhe detin: dhe të kaltër dhe të gjelbër, dhe të hirtë dhe të yjezuar.

Në thellësitë e syve, në largësitë e ujit bluja e errët priste pa mëshirë si me sharrë horizontin.

Vallja lozonjare e ngjyrave prush e zjarr më ndezi ashtu më këmbë nën teshat e bardha.

Së fundi u binda. Shpirti nuk qenka tjetër veç trup.

DRAMË PA ZGJIDHJE

Copën e bukës varur në spango na e tundnin lavjërës para syve majtas – djathtas - djathtas – majtas...

Kur sytë e pangopur vështronin përtej një copë mish, befasi hanim pas koke goditje çekiçi dhe mbeteshim dhe pa copën e bukës dhe përplasnim duart brenda rrjetës së merimangës të lumtur që s’ishim të lumtur dhe treteshim trutharë burgut të ndërgjegjes dhe mbetëm shpirtmykur kalasë së urrejtjes.

VETËMOHIMI

Kur fus dorën në xhep, nxjerr portofolin shaminë çelësat Botën? Jo veten. Veten? Po xhepi është i grisur...

BESIMI

Në Hënë në mars në Afërditë në qiell... Zoti s’u gjat që s’u gjat!

Ky është një cikël i autorit të njohur, me të cilin ai përshfaq shqetësimet e veta përmes një figuracioni të kujdesshëm në krijimtarinë e tij



Cili Zot?
Ai që ka vetëm emrin?
Ai që ka vdekur me kohë?
Apo ai që dikush e ka në xhep dikush në zemër dikush në kohë?

KAMBANAT E SË DIELËS

Vdekja pas perdes jep shfaqje pa spektatorë.

Aktorët kanë shkuar në faltore me luajt rolin e të pënduarve.

Kush po qesh me zë kambane atje Zoti apo Djalli?

Jeta në treg jep shfaqje lakurik.

BRENDA MEJE

Herë-herë brenda meje ngre çerden një zog i artë. I jap kokrra gruri, thekre, elbi... ai nuk e hap sqepin të këndojë për mua.

Herë-herë brenda meje qëndron një korb. Asgjë nuk i jap për të ngrënë. Ai kroat, kroat, kroat e pret vdekjen time.

Herë-herë brenda meje flatron një shqiponjë... Me mishin tim të freskët e ushqej, ajo më shqepon mushkrittë, unë i paguaj takshën.

KUR E KUR

Kur heronjtë vishen me leckë leckamanët bëhen heronj.

Kur truri i ditur ha mbeturinat e injorancës injoranca ushqehet e shkëlqen me trurin e ditur dhe vdes.

Kur kostumi vlen më tepër se trupi trupi ka shpallur me kohë nekrologjinë e vet.

Kur Hëna rreket të verbojë Diellin Dielli qesh e nuk rresht së ushqyeri Hënë e brishtë Hënë pa jetë.

A

ARTI

NGA BEN ANDONI*

Përballja me të shkuarën mbetet një nga sfidat më të mëdha të popujve evropianë dhe sidomos ato që deshtin natyror-historik i ka vendosur në Lindje. Arsyja lidhet me faktin se ndër-sa pas vitit 1945, Evropa Perëndimore filloi ta gëzonte paqen, lirinë dhe filloi të merrte veten falë Planit Marshall, Polonia dhe disa vende të tjera prej Evropës Qendrore iu nënshtruan një lloj okupimi të ri, që ishte ai sovjetik, varësisë prej tij në të gjitha fushat, kurse sa i përket historisë: manipulimeve, e më keq akoma shkatërrimit të kujtimeve, që erdhën si rezultat i zhvendosjes së dhunshme të popullatave nga Lindja në Perëndim. Në shumë vende të Lindjes, librat që do t'i kujtonin këto ngjarje nuk u lejuan të ishin publikë ose u anatemuan, kurse libra të tërë propagande, në vend të tyre, mbushën plot raftet.

Polonia, në ditët e sotme, ka dhënë një nga rastet më interesante të përbaljes me të shkuarën përmes artit. Dhe, mënyra sesi në art pasqyrohen kujtimet, në jo pak raste fillojnë me vendin ku ndodhi dikur ngjarja apo momenti që ngjall kujtesën për artistin. Poeti polak Tadeusz Gajcy, nga të parët, do të nënvizonte në veprën e tij se Polonia ka vende të panumërta kujtesë, që lidhen me data të dëmeve që i janë bërë popullit polak, vende ku janë përjetuar trauma kombëtare, pa harruar edhe vendet e fitoreve të lavdishme. Dhe, polakët, ashtu si nuk mund t'i harrojnë kurrsesi betejat e humbura, ekzekutimet e kalimtarëve të rastit në rrugët e Varshavës nga nazistët, përpjekjet e udhëheqësve të kryengritjeve polake kundër rusëve, historitë e jashtëzakonshme të mbrojtjes së qyteteve, vendet e torturës, vendet e vuajtjes e shumë gjëra me radhë, i kushtojnë kujdes dhe triumfeve të tyre historikë. Këto të fundit, të gjitha, janë të ngulitura në kujtesën kolektive madje arkivuar falë librave të mirë.

Instituti i Kujtimeve

Instituti kombëtar i Kujtimeve ose më gjatë Komisioni për Ndjekjen e Krimeve kundër Kombit Polak (*Polonisht: Instytut Pamięci Narodowej - Komisja Ścigania Zbrodni przeciwko Narodowi Polskiemu; IPN*) është institucioni që ka marrë përsipër përcjelljen e historisë ndryshe të Polonisë, por edhe institucioni që ka ndihur të shikohet ndryshe ajo. Ky institut kërkimor, që është ngushtësisht i lidhur me qeverinë polake, mbart në ditët tona edhe prerogativat lustracioni, por ka edhe kompetencat e prokurorisë. Legjislacioni për ndërtimin e këtij institucioni të kujtesës, ashtu si merret me mend, ka qenë i miratuar nga parlamenti, kurse vetë Instituti mbetet i fokusuar në shqyrtimin ligjor dhe historik të historisë së shekullit të 20-të të Polonisë. Për ata që se dinë IPN jo thjesht heton krimet naziste dhe komuniste të kryera në Poloni midis viteve 1939 dhe ngjarjeve deri në vitin 1989, por përpigjet që edhe të dokumentojë gjetjet e saj dhe t'i bëjë të aksesueshme rezultatet e hetimeve për publikun në forma të ndryshme.

Historia e Institutit fillon që nga miratimi i tij nga Parlamenti Polak më 18 dhjetor 1998. Ai e filloi punën më 1 korrik 2000. Kurse gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para, pas fillimit të tij, IPN arriti të grumbullojë mbi 90 kilometra arkiva, publikoi plot 1.794 raste të hetimeve, organizoi ngado 453 ekspozita, zhvilloi 817 konferenca dhe ka promovuar 30 portale për internet. Gjatë kohës së ekzistencës, Instituti zhvilloi intervista

Polonia, në ditët e sotme, ka dhënë një nga rastet më interesante të përbaljes me të shkuarën përmes artit. Dhe, mënyra sesi në art pasqyrohen kujtimet, në jo pak raste fillojnë me vendin ku ndodhi dikur ngjarja apo momenti që ngjall kujtesën për artistin. Poeti polak Tadeusz Gajcy, nga të parët, do të nënvizonte në veprën e tij se Polonia ka vende të panumërta kujtesë, që lidhen me data të dëmeve që i janë bërë popullit polak, vende ku janë përjetuar trauma kombëtare, pa harruar edhe vendet e fitoreve të lavdishme

Art/ Si të përballesh me të shkuarën në modelin polak



me mbi 103.000 dëshmitarë dhe mori në pyetje 508 persona të akuzuar për vepra penale, duke i çuar në 137 gjykime nga gjykatat e drejtësisë.

Ndërkohë që konform një ligji të ri, i cili hyri në fuqi më 15 mars 2007, IPN do të kishin mandat edhe për të kryer procedurat e lustrimit të përshkuara nga ligji polak. Gjithsesi, disa nga menet kyçe të këtij ligji janë vlerësuar si jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese e Polonisë më 11 maj 2007, kështu që roli i IPN-së në procesin e lustrimit është ende i paqartë. Ky është një nga elementët që e bën si shumë të ngjashme punën e Autoritetit shqiptar sa i përket qasjes me të shkuarën.

IPN është një anëtar themelues i Platformës së Organizimit të Kujtesës dhe Ndërgjegjes Evropiane, pjesë e të cilës është edhe Autoriteti Shqiptar i Hapjes së Dosjeve, që sapo ka nisur rrugëtimin e tij.

Në ditët që po flasim Instituti kishte kaluar në strukturat e saj rreth 527 raste, që lidheshin me Luftën e Dytë Botërore, duke i përgatitur çështjet e tyre për gjyq, nga të cilët 35 raste ishin gjykuar më vonë si të pafajshëm. Ka të ekstrapuar rreth 44 njerëz dhe puna vazhdon

Rikthim te kujtesa përmes artit

Përkujtimi i Katyn

Shumica e këtyre monumenteve ndërojnë njerëzit që kanë vdekur në ato vende, por disa prej tyre janë vendosur në vende alternative. Midis këtyre të fundit, më e shquara është seria e monumenteve të dedikuara për viktimat e Katyn-it. Jo vetëm polakët në Poloni, por edhe diaspora polake mbeten shumë të ndjeshme për këtë çështje. Si rezultat i kësaj përpjekjeje, sot qytete të ndryshme si Toronto, Kanada dhe Johannesburg, Afrika e Jugut, kanë sot monumentet kushtuar Katyn. Asgjë nuk e mobilizon diasporën polake sesa kur flitet për faktin që po ndërtohet një monument kushtuar Katyn.

Puna më kryesore, që është bërë nga autoritetet polake, lidhet me zbulimin e vendndodhjes së ngjarjeve, të cilat kanë përcjellë jo vetëm traumat por edhe lavditë e kombit polak. Në këto vende, fillimisht kujtesën e bënë qytetarët në mënyrë individuale porse një rol të madh luajtën teatrot e vendit, që me audiencat e tyre dhe një numër aktorësh patriotikë sollën shikimin e shumë ngjarjeve ndryshe, në atë që do konsideroheshin si risi. Krijimet satirike që bënë artistë si Mrozek, u panë si metafora të situatave të kaluara por edhe të tashme. "Epoka e Etërve" e Adam Mickiewicz, e interpretuar në teatrot në Varshavë dhe Krakov, u bë një rast për artikullimin simbolik të superioritetit moral mbi rusët, të perceptuar si armiq të Polonisë në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe gjithashtu në të njëzetën. "Endrra e Argjendit e Salomea" e Juliusz Slowacki, në mënyrë të mrekullueshme arriti që me performancën e saj në Teatrin Wielki në Varshavë në vitet 1980, të kthehej në një rast për një rrefim melankolik të gabimeve të kaluara të politikës ndaj Ukrainës. Të dy dramat



bashkëkohore dhe historike u interpretuan dhe më vonë u konsideruan si simbolikë e përpjekjes së punëtorëve që ranë gjatë protestave periodike në fabrikat në vend gjatë viteve 1956, 1970, 1976 dhe 1980. Shfaqjet u interpretuan edhe si një përgjigje për vrasjet e pazgjidhura të priftërinjve katolikë, burgosjen e kardinali Stefan Wyszyński, si dhe ekzekutimin në burg të disa mijëra patriotë polakë në vitet 1940 dhe fillimin e viteve 1950.

Në fakt, përpjekja nuk mbaron këtu, pasi arti polak mendoi që të shkoj përtej. Harta polake e memories gjithashtu u provua dhe u konfirmua nga filmat e shumë të atyre veprave të letërsisë polake që kontribuan në mitin bazik të qenies së Polonisë si një komb. Gjatë dekadave të fundit, shkrimtarët polakë treguan në mënyrë të saktë tragjeditë politike të vendit duke shkruar romane, poema dhe në gjini të tjera. Ato u transformuan pastaj në filma. Një transformim i tillë i suksesshëm ishte "Pan Tadeusz" nga Andrzej Wajda i cili thyen të gjitha të dhënat e audiencës që natën e parë në Poloni. Ka pasur filma mbi veprat e Henryk Sienkiewicz "Triologia" dhe "Quo Vadis". Kurse "Toka e Premtuar" nga Wajda (mbështetur mbi romanin nga fituesi i Nobel Wladyslaw Reymont) portretizoi vuajtjet e industrializimit, ndërkohë që "Njeriu i hekurit" ngriti shumë ngjarjet e kohës, që lidheshin me Solidarnost.

Nuk mbaron këtu. Pjesa e popullsisë që nuk frekuenton artin do të shfrytëzojë traditën duke ndëruar të rënë në varrezat polake në Ditën e Gjithë Shpirttrave, që festohen në vend më 2 nëntor të çdo viti. Si vendi ku kryesisht kryhen ceremoni fetare, varrezat do ishin përtej objektit të përgjimit të autoriteteve të qeverisë komuniste dhe mund të përdorëshin si vend grumbullues për ata që dëshironin të përkujtonin një ngjarje. Dhe "Dita e Shpirttrave" bën atë që se bën arti, ajo kthehet në një festë unike që kombinon nderimin për të afërmit, si dhe heronjtë e kombit. Në varrezën Powazki në Varshavë varret dhe monumentet përkujtimore të kryengritjeve të 1831, 1863 dhe 1944 marrin shumë vëmendje në "Ditën e Shpirttrave".

Monumentet

Ngritja e monumenteve, ashtu si edhe në Shqipëri ka qenë një mjet qendror për mënyrën polake të kujtesës. Monumentet e dedikuara heronjve të Luftës së Dytë Botërore në veçanti janë pjesë e peizazhit përkujtimor polak. Komunistët i lejuan këto monumente të ngriheshin për shkak të përkujtimin të luftës kundër nazistëve; kurse krimet sovjetike në Poloni mbeten subjekt tabu deri në vitin 1989. Pas rënies së komunizmit, krimet sovjetike filluan të përkujtoheshin, në një sens krejt tjetër. Shumica e këtyre monumenteve ndërojnë njerëzit që kanë vdekur në ato vende, por disa prej tyre janë vendosur në vende alternative. Midis këtyre të fundit, më e shquara është seria e monumenteve të dedikuara për viktimat e Katyn-it. Jo vetëm polakët në Poloni, por edhe diaspora polake mbeten

shumë të ndjeshme për këtë çështje. Si rezultat i kësaj përpjekje, sot qytete të ndryshme si Toronto, Kanada dhe Johannesburg, Afrika e Jugut, kanë sot monumentet kushtuar Katyn. Asgjë nuk e mobilizon diasporën polake sesa kur flitet për faktin që po ndërtohet një monument kushtuar Katyn. Rasti në fjalë dhe propaganda për të tregojnë se trauma Katyn është e zhytur thellë në kujtesën kolektive. Nga të gjitha vrasjet e polakëve prej sovjetikëve kjo është kujtuar edhe më së miri. Deri kohët e fundit ishte e vështirë të zbardhej, pasi qeveria ruse ka ngurruar të pranohet fajin, e lëre të bëjë ndryshime simbolike. Rusët më në fund kanë pranuar bashkëpunimin e tyre në vrasje, por asnjë ndjekje simbolike nuk është realizuar. Gjatë vizitës së Presidentit Putin në Poloni në janar të vitit 2002, ai e hodhi poshtë çështjen e apologjisë. Kurse, pak para kësaj vizite, Gennadi Ziuganov deklaroi se asnjëherë nuk duhet të jepet asnjë ndjesë për Katyn, sepse nuk duhet harruar që sovjetikët humbën gjysmën e milion njerëz duke "çliruar" Poloninë.

Ndërkohë që edhe ngjarjet e dekadave të fundit të shekullit XX kanë sjellë gjithashtu një numër monumentesh. Një i tillë i kushtohet demonstrimit të punëtorëve që u zhvillua në Gdansk në vitin 1970, gjatë së cilës policia vrau një numër pjesëmarrësish. Në përgjigje, menjëherë pasi u legalizua Bashkimi i Punës së Solidaritetit, u ngrit një monument për punëtorët e vrarë në dhjetor 1980. Mu në hyrje, në kantierin e ndërtimit të Gdanskit punëtorët ndërtuan tre kryqe të montuara në trarëve prej celiku shumë të gjatë. Mbishkrimi poshtë thotë: «Zoti i jep forcën popullit të tij, / Zoti i jep bekimin e paqes popullit të tij» (Psalmi 29).

Nga dhjetë vendet e pranuar në Bashkimin Evropian më 1 maj 2004, Polonia do ishte vendi më i madh i pranuar. Ndërkohë që polakët iu la të mendojnë se Evropa i mirëpriti, prania e tyre duket si e pasigurtë dhe kjo duket nga fërkimet e shpeshta të Unionit me vendin. Gjithsesi, duke u kthyer te kujtesa, ndërsa Fukujama do të shpallte gabimisht fundin e historisë, disa mendimtarë vumë në dukje se njerëzimi mund të ishte shumë më mirë nëse historia do të harrohej plotësisht, nëse të gjithë do përbënim një popull pak kujtesë. Të gjitha këto mbeten natyrisht, utopike. Liria për të kujtuar dhe ruajtur kujtimin e së kaluarës është një kusht i nevojshëm për një shoqëri të civilizuar që të ekzistojë.

Sot, Polonia përballet jo thjesht me kujtesën por edhe me problematikën e institucionit që merret me të. Jo më kot, zgjedhja e presidentit të ri të IPN në dhjetor 2005 mbeti e diskutueshme. Janusz Kurtyka, presidenti i IPN, u kontestua nga Andrzej Przewoźnik. Vetë kandidatura e Przewoźnik do të pengohej pas gjetjes së dokumenteve që hidhnin dyshime për bashkëpunimin e tij të mundshëm me Służba Bezpieczeństwa, agjencinë e brendshme të inteligjencës dhe policinë sekrete të Polonisë. Przewoźnik do të pastrohej nga akuzat vetëm pasi kishte humbur zgjedhjet. Fatkeqësisht goftë Przewoźnik dhe Kurtyka të dy do të vdesin në rrëzimin e Tu-154 të Forcave Ajrore të Polonisë 2010 bashkë me presidentin polak dhe shumë personalitete të tjerë. Veprimet e IPN-së gjithashtu kanë tërhequr mbështetje, por edhe kundërshti. Në vitin 2006 u bë një përpjekje kombëtare për katarsis, kur intelektualët vendas botuan një letër e hapur, duke deklaruar se: «Historia e kundërshtimit të totalitarizmit i takon miliona polakëve dhe jo një grupi social apo politik që uzurpon të drejtën për të mbrojtur gjoja të drejtat e njeriut. Të vendoset se cilat pjesë të historisë kombëtare duhet të diskutohen dhe të harrohen». Asokohe letra mbante firmat e personaliteteve të mënjohura në vend.

Sot, Polonia, është një nga vendet që përballet hapur me të shkuarën e vet dhe vendoset të ndahet nga ajo pjesë e dhimbshme që e ka helmuar për dekada të tërë, mendjen dhe shpirtin e popullit. Arti ka shërbyer që ky shërim fillimisht të vijë përmes përgatitjes së saj.

Fillim-Verë 2017, Warsaw

P

POEZIA

NGA NDREK GJINI

Fusha dhe unë

Dje mbasdite,
Unë dhe livadhi premë flokët.
Ashtu bashke
Nata na zu jashtë.
Shiu na e beri një dush
...Pa lejen e hënës.

Sot në mëngjes
Fushën e zgjoi një puthje e lehte ylberi.
...Mua, telefonata e nënës.

Peizazh dhimbjeje

...1997
Male.
Veç male urrejtje,
pa fund e ane.
E shtigje ankthi,
që përcjellin të vrarë.

Autori shkruan tashmë në anglisht, por hera-herës provon edhe në shqip. Po botojmë disa poezi të tij, që janë shkruar në shqip



Askund s'te rrok syri,
pemë shpresë,
...as bar.
Veç hije krimdash,
e lot qelibar.

Fjalët dhe këpucët

Fjalet dhe keputet m'u vjetruan krejt,
shpërfillja dhe balta po i brejne perdite.
Koha per to s'ka varr as monument.
Ka vetem cinizem, harrese e frike.

Letër nga burgu
(Peizazh nga Irlanda)

I dashur mik
Këtë letër per ty
E shkrova këtu,
Ne burgun e gjelbër.
Ku fjalës mi vjen era bar.
E ëndrrat përditë
Me lagen ne shi.

Këtu, ku jeta dhe vdekja
Nuk kane kufi.

Ku bari, shiu dhe lulet
Vdesin e ringjallen brenda ditës
Si me magji.

Ky shi

Ky shi qe s'ka te sosur
Ma ka ndryshkur kujtesën.
Dhe shpresën
Si Rozafe
Ma ka murosor.

Ky shi qe s'ka te sosur.

T

TREGIM

NGA PETRAQ PECANI

Pavarsisht se godita gishtin e vogël të këmbës së djathtë, rrëmbeva receptorin dhe mezi arrita të nxirrja zërin tim paqësor:

- Urdhëroni, zotëri!!!
- Jam grauja e Sinanit - ishte përgjigja matanë. - A mund të ma sjellësh porosinë e Sinanit Te Ura e Milotit!.. Se deri aty zbris vetë me furgon... - vazhdohte e sigurt ajo femër që me siguri nuk dinte se me kë fliste.
- Më falni, zonjë!.. - i thashe duke mos kuptuar asgjë nga ato që dëgjoja e duke shtrënguar me dorë gishtin e vogël të këmbës që kish filluar të më digte ja ktheva. - Keni ngatërruar numrin, zonjë!.. - dhe përplasa receptorin disi i nervozuar për t'i dhënë fund asaj katraure.

Por, pas pak, zija çerriti përsëri.
- Jo, mor burrë... - ngulmoi ajo. - A nuk je ti filani!?! - Me befasoni duke cituar emrin tim. - porosinë e Sinanit e keni prur dhe me shoferin, prej...

Ah, shoferi!.. Me siguri, e gjithë, kjo anomali, ishte bëma e tije. Ashtu turbullt m'u kujtua, që, sëbashku me ngarkesën time, mbrëmjen e shkuar pat lënë edhe dy pako për të tjerët, por unë s'e prisja që, pa zbardhur dita, të më zgjonin e të filloja me shpërndarje pakosh.

- Po.. po, është një porosi, dhe.. duhet të jetë e Sinanit.. i thashë pa e ditur nëse kisha thënë të vërtetën.

- E Sinanit është, mor burrë, po a mundet me ma sjellë Te Ura e Milotit?!

- Do mundohem, zonjë! - i thashë i çoroditur gjersa të mblidhja veten dhe, ndofta, shpëtoja nga gracka tek kisha rënë.

... të falenderoj nga zemra... - ishin fjalët e fundit që më kapi veshi, para se të mbyllja

telefonin.

Në cast, ndeza dritat dhe celularin për t'i telefonuar shoferit, por, kur ndjeva se telefoni i tij nuk kishte sinjal, e hodha mbi shtrat dhe po vishesha.

Si u qetësova disi, në mendje më mbeti imazhi i bëshëm i shoferit... shoferit që më shërben për transportet e mallrave. Nga ai e pata atë mëngjes të hidhur. Po gjithsesi...mos e paragjykoni shoferin tim. Ai nuk është aventurier... Ai kryen transporte nga shteti fqinj, po vuan nga dëshira e mirë për t'i kënaqur të gjithë,

dhe kjo e bën të befet, gjithmonë i shqetësuar... por... edhe si tejet i ngatërruar!

Në kroskottin e kabinës së tij gjen përherë të ngjitura copa letre, me shënime adresa, e numra telefoni. Me porositë që sjell e me porosi që con. Në disa prej tyre shkruhet sipër: **urgjente**. Aty mpleksen porosi të vjetra e porosi të reja, porosi që janë kryer apo që presin të kryhen. Ato më të vjetrat kuptohen lehtë: se letrat e tyre kanë më shumë njolla grasoje apo vaji nga i makinës. Te rejat janë taze.

Ndërsa, porositë më të veçanta e më të rëndësishme, ai i ngjit te pasqyra e mesit të kabinës dhe i kujton sa herë bën injetro apo eshte i detyruar të shohe pas, pavarsisht se e pengojnë "pak" gjatë manovrimit.

Pra, kabina është si memoria e tij, funksionon si hark disk për lëvizjet që kryen. Ai gjithmonë është në lëvizje, gjithmonë duke kërkuar adresa apo persona të njohur e të panjohur. Mund të të thojë që, për pak, po mbrërrij dhe ti mund të presësh tërë ankh: orë të tëra, mbase dhe ditë të gjata pa mbarim. Dhe të qëllojë që edhe të mos të vijë fare.

Sakaq ka raste që ti s'e pret dhe ai të shfaqet në derë për të shkarkuar. Ndoth, që nga nxitimi, ngarkesën time ta lërë diku tjetër

Tregimi është një nga gjinitë më të vështira në letërsi, tekta shtjella e rrëfimit këtu mund të ishte pak më lakonike, por mbetet zgjidhja e autorit...

Të fala Sinanit

e porosinë e të tjerëve ta lërë tek unë e të zhduket si fantazëm. E keqja është se për këtë nuk njofton në castin e duhur.

Kohë më vonë, pas shumë përpjetsh nëpër telefona, sigurisht qe gjithësej cili do ta gjeje të vërtetën.

Provoja ta marrë shërisht ne telefon dhe mësova se porsa pat kaluar kufirin për në shtetin fqinj ku ai prej vitesh edhe banonte së bashku me familjen.

Mësova, gjithashtu, se shqetësimi i atij mëngjesi ishte për një sobë ngohjeje e përdorur që Sinani e dërgonte për familjen e vet këtu në vendlindje.

Që dy fëmijët e vegjël të Sinanit prisnin të ngroheshin nga ajo sobë...Ndaj, pra, shoferi më nisi me mesazh edhe numrin e celularit të gruas së tij. Të Sinanit pra. Unë i premtova se do ta zgjidhja atë problem. Dhe, me të vërtetë, duke qenë motiv njerëzor dhe, sigurisht prekës, do të ndihmoja për ta zgjidhur.

Po mendoja të merrja makinën e të shkoja në magazinë, të ngakojja sobën e Sinanit, e të niseshin drejt një ure...ura...; Ura e Milotit! Më erdhi në mendje. Në cast, u stepa. Truri im tashmë ishte i vetëdijshëm dhe perceptonte me saktësi objekte e distanca reale. Ura e Milotit... shumë larg!..Dhe...Dhe e pamundur!! Në axhendën e ngjeshur të ditës sime nuk gjeja hapësirë për atë udhëtim.

Për këtë i kërkova ndjesë...dhe ajo e kuptoi situatën time, ndaj takimi u la pas tri orësh Te Rrethrotullimi i Zogut të Zi ku, në përgjithësi, si më tha, ndalojnë furgonat që vinin nga zona e saj.

Si formova numrin e celularit, po hetoja personazhet e mundshëm për të qëllur



Vijon në faqen 20



...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte shumë mirë e disenjuar me temat. Shkrimi kryesor iu blatua historisë së fotos së vërtetë që lidhet me Pavarësinë. E shkrepur një vit më vonë, ajo ishte edhe dokumenti zyrtar sa i përket kësaj ngjarje të madhe. Autori i saj është Petro Dhimitri një profesionist, punët e të cilit autori Qerim Vrioni i kish shpjeguar shumë mirë, madje edhe me kontekstin e ditëve. Shqetësimi i autorit ishte për autorësinë e vetë fotografisë, një sëmundje e pashërueshme kjo për shqiptarët. "Fotoja pasqyron festimet në Vlorë, para godinës së

Qeverisë së Ismail Qemalit, të përvjetorit të parë të Shqipërisë së Pavarësisë, më 28 Nëntor 1913. Gjithsesi, rrallëherë në publikime, fotografia shoqërohet me emrin e autorit, mangësi e pafalshme, por fatkeqësisht, e zakonshme në shtypin dhe botimet shqiptare". Në fakt, për shumë njerëz, fotoja është identifikuar me atë të pavarësisë dhe ende sot shumica e shqiptarëve nuk e dinë historinë e saj, që historiani i fotografisë e ka zbërthyer shumë qartë.

Profesor Rexhep Ferri përmes esesë së tij "Herët na ka kënduar Qyqa" shkruan conceptualisht për atë botë që e rrethon dhe që do t'i kumtojë mesazhet e tij. Duket si një botë virtuale dhe tejet larg së përdit-

shmes, por një sy i vëmendshëm dhe afër tij i shikon shqetësimet kombëtare, që ai mundohet t'i blatojë dhe në formatin e tij pikurik tejet filozofik, shkroi redaktori.

Luan Rama, poeti, kineasti dhe publicisti, që jeton në Paris prej vitesh, rikthehet me një cikël, që vjen pas shumë kohësh të "Milosao". Botuesi i tij i ka përçarur dhe konsideratën përmes një letre të kujdesshme... e cila është botuar nga redaktori.

Ndërkohë, që në këtë numër pati vend edhe për studiuesen e njohur, prof. Kaliopi Naska, që në vazhden e punimeve të saj historike, këtë herë në një formë shumë të larmishme por edhe lehtësisht të asimilueshme për publikun, na ka sjellë

albumin studimor historik "Vetëqeverimi i Korçës, referuar të përkohshmeve 'Adriatiku' dhe 'Gazet' e Korçës". Redaktori për pak e harroi në vazhden e shkriemeve të shumta, që ishin në këtë numër. Referuar materialit të dy gazetave, ato ishin edhe kronika më e gjallë ku përshkruhen ngjarjet e atyre ditëve në Korçë. Me një metodologji tepër komunikuese dhe të pastër, ofruar prej saj, lexuesi kupton dhe orientohet në një nga ngjarjet më të mëdha të historisë kombëtare në dekadat e para të shekullit XX...

Në përgjithësi ishte numër i këndshëm dhe i matuar shumë mirë dhe në disa momente dhe layout ishte përshtatur shumë mirë.

→ Vijnë nga faqja 19

NGA PETRAQ PECANI

ar tek ajo që kërkoja. Arrita të pikasja një grua të bëshme me veshje të asaj zone, e cila ngriti aparatën e vogël të telefonit. Me c'nuhata ajo u shkëput, nga dy fëmijë, e po hetonte rreth e rrotull për t'më gjetur.

- Më falni, zonjë... ju jeni gruaja e Sinanit!?

- Po, mor burrë, une jam... Ajo më zgjati dorën gjithë respekt dhe, pa mbaruar mirë fjalën u drejtua fëmijëve që vazhdonin të më shihnin me admirim.

- Takojeni shokun e babit... u tha duke i kapur nga supet, dhe të dy i solla drejt meje.

Në çast, desha t'i kundërshtoja, t'i sqaroja se nuk e njihja Sinanin, se ishte shoferi ai që... po, kur pashë shprehjen e fytyrës së atyre vogëlushëve, ngurrova dhe ndryshoja mendje: Nuk doja t'i zhgënjeha e t'u hiqja nga sytë atë shkëlqim mirënjohës.

- Më ka thanë Sinani në telefon që sobën do ta sjellë një njeri shumë i mirë, dhe tash po të shoh vetë se ç'njeri qenke.

Unë miratoja me zell, po njëkohësisht ndihesha në siklet: më vriste ndërgjegjia për atë që po ndodhte.

Zilja e telefonit më shkëputi nga ajo gjendje dhe më kujtoi punët e shumta që më prisnin.

Gruaja u foli fëmijëve për t'u përhëndetur dhe m'u drejtua:

- Nuk po të vonoj, po dy gjëra kam për t'i thanë: E para: rrofsh që ma zgjidhe

këtë hall e Zoti ta shpërbleftë! E dyta: i thuaj Sinanit që fëmijët i ka si kokrra e mollës, prandaj t'i solla të dy që t'i thuash se i pe me sytë e tu.

Unë miratoja në heshtje me gjithë se mendjen e kisha të turbullt.

Nëna e vocërrakeve vazhdoi:

E treta: i thuaj Sinanit t'i mbarojë ato të shkreta letra e të vijë se i ka marrë malli fëmijët, po edhe fisi pyet për ditë... E fundit; kur të ikësh prapë, du me t'dhan një gjatë vogël që ma ka kërku Sinani; nga java tjetër t'u na nis me kunatin, se ai vjen shpesh në Tiranë.

I skuqur në fytyrë, mbeta me gojën kyçur.

Unë pata kohë që nuk shkoja në shtetin fqinj! Nuk ishte problemi i porosisë së saj, se atë mund ta nisja me shoferin në rrugën e ardhshme, por si do të shkote puna e këtij roli që luaja padashje!

- Kur ke me u nis...? - pyeti sërish ajo.

- Shumë shpejt... i thashë për ta mbyllur takimin.

Tashmë nuk ia vلente t'i thosha

Të fala Sinanit

të vërtetën. Le që do të dukesha qesharak para saj dhe fëmijëve. Dhe, që atë cast, mendova për shoferin... jo vetëm për porosinë, po, më tepër, për të marr informacion për Sinanin, përshkrimin e tij fizik, gjithashtu edhe hollësi të tjera rreth statusit të tij.

Kjo do të ma qetësonte disi ndërgjegjen.

Kunati i Sinanit: një burrë thaim dhe energjik, ishte i mirëinformuar rreth personit tim. Që në takimin e parë, ai m'u hodh në krah duke më përqafuar si të njiheshim prej vitesh. Njëherë dorë ma mbajti në sup gjatë bisedës, e, me tjetër nuk lëshonte dorën time. Pasi më pyeti, se pari, për familjen më bombardoi me pyetje për Sinanin aq sa po më hutonte edhe më.

- Më ka marrë malli shumë për Sinanin; shkonim shumë me njeri tjetrin... po më thuaj... më thuaj diçka për shejtanin, ato balluket i ka akoma apo i ka prerë?

- I ka prerë pak... i thashë duke qeshur, paksa i përmbajtur duke mos ditur asgjë për pamjen e tij.

Po të mos i ketë prerë!... më thosh një zë i brendshëm. Nuk do të harroja që t'i kërkoja shoferit të më sillte një foto të Sinanit në rastin më të parë.

- Edhe që është shëndosur e kam marrë vesh... vazhdoi ai.

- Po, ka marrë ca kile... pasova unë.

- Eh... mor mik, e di që s'i thua të gjitha... po e kam marrë vesh që si dërr është bërë. Po të punosh në furrë buke, e ç'farë do bësh tjetër! Po mirë që filloi punë aty se ngeli roje... si buf nate... vetëm natën nuk punohet gjithë jetën, or mik!

Pronari e di që e ka për zemër, po, siç kam dëgjuar, edhe shefi i policisë së zonës paska respekt e do t'i bëjnë letrat... për hajër qoftë!..po hajt, or mik, pimë një kafe!

Ai më lëshoi dorën dhe më tregoi derën e një lokali.

Për t'u shmangur, i tregova makinën që kisha lënë me fleshët ndëzur, për më tepër doja t'i shmangesa pyetjeve të tija të shumta. Eh Sinan... Sinan, në ç'bela më ke futur... mendoja me vehte.

Nuk duhet të piqesha me askënd, pa takuar më parë me shoferin nga i cilin me siguri do të kisha informacion të bollshëm për t'u përballur me situata të tilla.

Duke çuar cantën te makina, më pyeti se kur mund t'i dilnin letrat Sinanit, sa e paguante pronari në



muaj, sa paketa cigare pinte në ditë, e për kë ngrinte doli kur uleshin në klubin e atij fshatit. Para se të mbyllja portbagazhin, më spjegoje se çfarë kishte brenda çanta duke e hapur e përcajtuar një e nga një.

- Këto dy kile duhan i ka për pronarin, po është duhan ama! ndërësa kjo shishja

me raki është për shefin e madh... atë të letrave!

Më sqaroi se fasulet ishin të reja e zienin shpejt, e për gjizën, kur ta provonin të lokali i fshatit, le t'i jepnin përshtypjet në telefon.

Mbylli bisedën me dy këshilla specifike për Sinanin: Të linde duhanin, e të hiqte ca kile.

Gjithashtu, më tha se isha i ftuar në festën që do të organizonin ditën që do të kthehej Sinani në fshat.

Për çudi, shoferin munda ta kap në telefon. Kishte për të shkarkuar pranë Kryqëzimit të Doganës e do të qëndronte mbi gjysmë ore aty. Më premtoi të pinim një kafe bashkë.

Mora makinën e nxitova, se mos më ikte. U ula në lokalin ku lamë takimin dhe prisja me padurim që të vinte.

E pikasa nga larg tek ecte me duar në xhepa e duke u lëkundur herë majtas e herë djathtas.

Pa u ulur mirë, e pyeta:

- I ka prerë balluket Sinani!??

- Nuk e di, se mos e kam parë ndonjëherë... mu përgjigji dhe iu drejtua kamarjerit për t'i dhënë porosinë.

Kjo më befasoi: mendova se bënte shaka, sepse diçka e këtille nuk ishte në natyrën e tij.

- Të lutem, e kam seriozisht! - Të vërtetën po të them, nuk e kam takuar asnjëherë në jetën time - vazhdoi ai qetësisht.

- Po sobën ku e more...?!

- Ma sollti komshiu im atje që ja kishte dhënë pronari i Sinanit, për gruan e Sinanit!

- S'po të kuptoj! - e ndërpreva duke e parë në sy.

- Po më dëgjo njëherë, mor burrë, që ta kuptosh!... Atje ku banoj unë kam një

komshi pensionist. Jeton i vetëm, po është zotëri burrë. Ai, çdo të shtunë shkon në fshatin e lindjes e kthehet të hënën. Është disa orë larg ai fshat, por ia vlen që të shkosh. Unë vetë nuk kam shkuar, por ç'ndodh në atë fshat i di të gjitha se m'i thotë gjithçka që sapokthehet. Ai vend shquhet për një verë të rrallë që prodhon. Atje ai ka prona, ullinj e vreshta e një shtëpi rrethuar me limona. Shtëpinë e prindërve që nuk i rrojnë. Por ka edhe një mik të ngushtë, mik të fëmijërisë. Ai, është pronari i Sinanit. Miku i tij, veç vreshtave, ka një furrë buke në qendër, ngjitur me lokalin kryesor të fshatit. Kur takohen, komshiu im i flet për mua mikut të vet, e miku i tij i flet për Sinanin. E kur ndahen, komshiu vjen e më tregon për Sinanin e miku shkon e i tregon Sinanit për mua. Kështu unë di shumë për të e ai për mua, po s'jemi takuar kurë! - beri një pauz për të rruftur kafene e vazhdoi:

Burrat e moshuar në atë fshat ulen në lokal me një gotë uzo, dy cironka e tri kokrra ullinj në pjatë, me orë të tëra qajnë hallat e gjithë botës. Në darkë, burrat ja thonë

grave e gratë diskutojnë me njëra tjetrën. E fshati zien si koshere. Mund të fillojnë me historinë e Levinskit e përfundojnë të byreku me kungull i gruas se Goles. E nisin me Cernobilin dhe e mbyllin me Fukushimën. Po të gatuaj diçka të vecante një nikoqire në fshat, do ta dinë të gjithë në kafene... Të mos harrojmë porosinë, or aman... Dhe hajde dëgjo komshinë pastaj... atje presin të provojnë gjizën që ka bërë gruaja e Sinanit.

E mbylli ai historinë e vet. Histori që më bëri të heshtë e të mos bëj më asnjë pyetje tjetër.

Dikush që erdhi nga jashtë lokalit e njoftoi se shkarkimi kish mbaruar dhe unë

e shoqërova shoferin me makinën time.

Kamioni i tij qëndronte në një fushë me gropa pranë një ndërtese të vjetër. Fusha lidhej me një rrugë të paasfaltuar e cila përfundonte në rrugën kryesore e, më pas, në autostradë.

Ai u ngjiti me ngadalë në shkallët e kabinës, duke u kapur në dorezën metalike.

Unë i zgjata cantën për Sinanin, të cilën e futi, me vështirësi, në derën e kabinës në të cilën të shumtën e hapësirës e kishte bllokuar me trupin e vet. Më pas, u ul në sedile duke peshuar rëndë, dhe i rehatuar, nxori nga kroskoti një palë syze të mëdha të harkuara me xhamat me refleks. I kapi me dy duar nga bishat dhe me një lëvizje delikate po i kalonte mbi veshë, e, me siguri ato do t'i mbulonin një pjesë të konsiderueshme të fytyrës.

- Kam edhe një porosi, - i thashë, kur pash që erdhi casti i nisjes.

Ai tërhoqi sërish syzet me ngadalë, po me të dyja duart dhe i vendosi në pjesën para timonit. Dhe u kthye nga unë.

- Më thuaj...

- Dua t'i bësh të fala... Të fala Sinanit!..

- Pa diskutim... ma ktheu, duke u zgjatur për të marrë bllokun e letrave.

Shkëputi njëherë nga fletët dhe e ngjiti me kujdes në një nga vendet bosh që kish mbetur mbi kroskot. Sipër shkroi TË FALA SINANIT, dhe më poshtë emrin tim të telefonit. Pasi la stiololapsin, në një mbajtëse të posaçme, u kthye nga unë;

- Nesër mbrëma kam mbërritur e në darkë takoj komshinë, pas tre ditësh, të shtunën që vjen, ai nisët... të dielën atje, te Klubi i Fshatit porosia është e mbaruar.

Vendosi sërish syzet, i dha gaz makinës, e duke lëshuar freksionin me ngadalë, kamioni u nis duke u lëkundur bashkë me të.